

Bashkëpunimi mësues-nxënës-prindër

Takimet me prindërit do të zhvillohen sipas këtij kalendari:

Takimi	Data
1	30 shtator 2021
2	16 dhjetor 2021
3	13 prill 2022
4	10 qershor 2022

Orari i veprimtarive ditore në arsimin parashkollor:

Ora	Veprimtaria ditore
09:00	Ngrënia e mëngjesit
10:00	Mësim
11:00	Lojëra
12:00	Dreka
13:00	Koha e pushimit, fjetja
16:00	Largimi për në shtëpi

Nehemiah Gateway Albania
Rr. Nehemia
7304, Buçimas Pogradec

Elona Rira
Drejtoreshë e Shkollës NEHEMIA

T:+355 83 600403
F:+355 83 600405
C:+355 69 70 58 359
E:elona.rira@ng.team



Shkolla NEHEMIA



Arsimi Parashkollor

Synimi i Kopshtit NEHEMIA

Të sigurojmë një edukim cilësor, i cili u mundëson fëmijëve të zbulojnë vetveten, të formojnë personalitetin, me qëllim që ata të jenë në gjendje të mbajnë përgjegjësi për jetën e tyre.

Objektivat e Kopshtit NEHEMIA:

- Identifikimi dhe nxitja e prirjeve të fëmijës.
- Zhvillimi i personalitetit të fëmijës nëpërmjet mësimdhënies praktike, lojërave dhe aplikimit të qendrave të të nxënës.
- Krijimi i një klime pozitive, të ngrohtë dhe miqësore për fëmijët.

Fushat e shërbimit

Në Kopshtin NEHEMIA janë parësore këto fusha:

1. Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik i fëmijëve.
2. Zhvillimi personal, social dhe emocional.
3. Zhvillimi gjuhësor dhe komunikimi.
4. Zhvillimi njohës dhe njohuri të përgjithshme.
5. Edukimi sipas vlerave morale të Nehemiah Gateway Albania.

Kujdesi ndaj fëmijëve

Mësueset shoqërojnë fëmijët në ardhjen e tyre në kopsht dhe në përcjelljen e tyre për në shtëpi me autobus.

Projekti i shërbimit social e mjekësor ofron përkujdesje mjekësore për fëmijët në çdo rast.

Mensa moderne me një personel të kualifikuar ofron gatime me vlera ushqyese e të shijshme.

Psikologu i shkollës ofron ndihmë profesionale në shërbim të nevojave psiko-sociale të fëmijëve.

Veprimtari

Veprimtaritë edukative të kopshtit u përgjigjen nevojave fiziologjike, emocionale dhe intelektuale të fëmijëve dhe ato janë të organizuara në mënyrë graduale në përputhje me moshën.

Veprimtaritë ditore të kopshtit përfshijnë një larmishmëri veprimtarish si:

- Mësime dhe situata komunikimi të organizuara me fëmijë dhe të rritur për të zhvilluar aftësitë gjuhësore, shkencore dhe sociale të tyre.
- Mësimdhënie me në qendër fëmijën.
- Lojëra të shumëllojshme, për zhvillimin shumëplanësh të fëmijëve.
- Mësim i gjuhës angleze dy herë në javë për grupin e tretë.



Bazuar në planin vjetor, kopshti do të organizojë këto veprimtari kryesore çdo muaj:

Muaji	Veprimtaria
Tetor 2021	Dita e librit
Nëntor 2021	Veprimtari me rastin e festave të 28-29 Nëntorit
Dhjetor 2021	Festojmë Krishtlindjen dhe Vitin e Ri
Janar 2022	Karnavale me veshje kafshësh
Shkurt 2022	Të drejtat e fëmijëve
Mars 2022	Festojmë 7-8 Marsin Ekskursion Pranveror
Prill 2022	Dita e Balonave
Maj 2022	Dita e Gjyshërve
Qershor 2022	Dita e Fëmijëve 01.06.2022

Struktura e vitit shkollor 2021-2022

Për datat e pushimeve dhe ditët e festave kombëtare, shkolla respekton kalendarin e pushimeve zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Mësimi: Viti shkollor fillon më 1 shtator 2021 dhe vazhdon deri më 30 qershor 2022.

Pushimet: Fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.

Ndarja e certifikatave: Për fëmijët e grupit të tretë do të bëhet ndarja e certifikatave me mbarimin e arsimit parashkollor në datën 24 qershor 2022.



Mësimi gjatë verës: Për muajt korrik dhe gusht Kopshti NEHEMIA do të qëndrojë i hapur dhe për ata prindër, të cilët kanë dëshirë të sjellin fëmijët e tyre edhe gjatë verës. Shërbimi do të ofrohet sipas tarifave të përcaktuara.